MITROVICA
KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.
Rruga e Liqenit p.n. – 40000 Mitrovicë
Data 19.11.26 Nr. 3172

NJOFTIM

Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë njofton publikun dhe kandidatët e interesuar se, me Vendimin e Kryeshefit Ekzekutiv nr. 01-3171, të datës 19.11.2026, është anuluar në tërësi konkursi i publikuar më 13.10.2026, me nr. protokolli 2936, për pozitën:

Inxhinier/e përgjegjës/e i/e Elektroenergjetikës

Konkursi është anuluar ngase asnjë nga kandidatët që kanë aplikuar nuk i ka plotësuar kushtet e veçanta të shkollimit të kërkuara me konkurs, me ç'rast vazhdimi i procedurës do të ishte në kundërshtim me kushtet e konkursit dhe me parimin e barazisë së kandidatëve. Vendimi është marrë në pajtim me nenin 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenet 47 dhe 53 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenet 8, 10 dhe 27 të Rregullores për Procedurat e Rekrutimit të Kompanisë.

Për pozitën në fjalë do të shpallet së shpejti konkurs i ri, prandaj i inkurajojmë të gjithë të interesuarit që t'i përcjellin njoftimet dhe konkurset e publikuara në ueb-faqen tonë.

Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" Sh.A.

Zyra e Burimeve Njerëzore